



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA GRAMSH**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE ME SIPËRMARRJE,TRANSPORTEVE,STREHIMIT**  
**DHE EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr 4410 prot.

Gramsh, më 26 / 11 / 2021

**Lënda :Kthim-përgjigje kërkesës Nr.4410 Prot.,date 22.11.2021**

**Drejtuar: Znj.VILMA BEQA**  
**Rr.Man Hatan,Nd.24,Ap,10,1030,Kamëz Tiranë**

Në përgjigje të kërkesës suaj Nr.4410 prot.,date 22.11.2021 në të cilën kërkon informacion nga bashkia jonë mbi zbatimin e ligjit nr.22/2018 “Për strehimin Social” ju bëjmë me dije se:

1. Qytetarët informacionin në lidhje me strehimin social e marrin nëpërmjet afishimit të njoftimeve në stendat e njoftimeve në katin e pare të institucionit,gjithashtu edhe në çdo kohë pranë zyrës së shërbimeve publike ku ata informohen për çdo program strehimi që ofron bashkia jonë.
2. Në lidhje me Programin e Banesave Sociale me Qira (BSQ) ,bashkia Gramsh nuk ka në pronësi të saj banesa sociale që të mund t’i jape me qira ,pra nuk kemi një fond publik të banesave sociale ,gjithashtu pranë nesh nuk kemi subjekte që shprehin interesin të rregjistruhen për të përfituar statusin e “pronarit e social” .Pavarësisht këtij fakti bashkia jonë ofron subvencionim e qirasë i cili është një instrument i programit të banesave sociale me qira ,që ndihmon individët /familjet që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale .Subvencionimi i qirasë ofrohet për ato familje që plotësojnë kërkesat ligjore si edhe sigurojnë Kontratën e Qirasë.Për shkak se bashkia jonë është me të ardhura të ulëta nuk ka parashikuar në buxhetin e vet fond për subvencionin e qirasë por ka kërkuar fonde nga buxheti i shtetit.
  - Gjatë vitit 2019 e kanë përfituar subvencionimin e qirasë 42 familje ,të cilat i përkisnin këtyre kategorive: 30 familje PAK,6 familje me ndihmë ekonomike,1 viktimë e dhunës në familje,5 familje gra kryefamiljare.
  - Gjatë vitit 2020 kanë përfituar subvencionimin e qirasë 64 familje,të cilat i përkisnin këtyre kategorive : 39 familje PAK,17 familje me ndihmë ekonomike,7 familje me gra kryefamiljare,1 viktimë e dhunës në familje.
  - Gjatë vitit 2021 e kanë përfituar subvencionimin e qirasë 22 familje,të cilat i përkisnin këtyre kategorive:14 familje PAK,1 familje vajzë –nënë,3 familje me ndihme ekonomike,4 familje me gra kryefamiljare.
3. Gjatë 3 viteve të fundit bashkia ka ofruar 40 banesa me kosto të ulët për familje të cilat kanë aplikuar konform legjislacionit në fuqi dhe kanë përmbushur të gjitha kriteret e duhura ligjore.Këto banesa janë përfituar nga ndërtimi i një pallati 8 katësh nga Enti

Kombëtar i Banesave dhe iu janë ofruar qytetarëve me vlera sipas kostove të ndërtimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

4. Programi i Shtepive të Specializura nuk zbatohet në bashkinë tonë.
5. Këshilli Bashkiak Gramsh ka miratuar sistem pikëzimi me vendimin Nr.18, date 25.02.2019 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, gjithashtu ka miratuar sistem pikëzimi me vendimin Nr.7 datë 29.01.2021 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga programet sociale të strehimit ( Blerje të banesave të ndërtuara nga EKB). Vendimet në të cilat janë miratuar sistemet e pikëzimit i gjeni në faqet e bashkisë Gramsh si dhe në adresën [vendime.al](http://vendime.al) ku hidhen të gjitha vendimet e këshillit bashkiak Gramsh.
6. Në lidhje me buxhetin e disponueshëm për strehimin social gjatë viteve 2019/2020/2021 ashtu siç është përmendur më lart për shkak të të ardhura të ulëta nuk kemi bërë parashikime të tilla nga buxheti jonë por kemi kërkuar fonde nga buxheti I shtetit sipas tabelës më poshtë:

Titulli i Projektit	Subvencionimi i qirasë		
	Familje të strehuara		
Lloji i Produktit	Numër		
Njësia Matëse	Numër		
	2019 Buxheti	2020 Buxheti	2021 Buxheti
Sasia e produktit(nr.familje)	42	64	22
Kosto totale e buxhetit	1 358 128	2 197 681	1 741 320
Buxheti i bashkisë	0	0	0
Financim nga donatorë	0	0	0
Kërkesa për mbështetje buxhetore	1 358 128	2 197 681	1 741 320

Faleminderit për mirëkuptimin ,

**KRYETARI**  
**Klodian TACE**

